



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

BULETINI STATISTIKOR

JANAR - PRILL, 2025

Tabela e Lëndës

- 1 KLSH përmes shifrave
- 2 Treguesit kryesorë të veprimtarisë audituese
- 3 Opinione/Mesazhe/Konkluzionet auditimi
- 4 Niveli i Pranueshmërisë së Rekomandimeve
- 5 Menaxhimi dhe Zhvillimi i Burimeve Njerëzore
- 6 Programi i Transparencës dhe e Drejta për Informim
- 7 KLSH në media
- 8 Aneksë

AKRONIME

ISSAI - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

EUROSAI - Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit

GAO - Zyra e Përgjegjshmërisë Qeveritare, SHBA

ECA - Gjykata Evropiane e Audituesve


CEF - Qendra e Ekselencës në Ekonomi e Lubjanës

SAI - Institucione Supreme të Auditimit

TIK - Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

TI - Teknologjia e Informacionit

1. AKTIVITETI I KLSH PËRMES SHIFRAVE



* 2 auditime përputhshmërie , 1 i kombinuar , 1 përputhshmërie për çështje të veçanta (Tematik)


** Për subjektet të cilat nuk kanë kthyer përgjigje mbi programet e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna, këto masa janë konsideruar "pranuar". Kjo shifër korrigjohet dhe plotësohet në Buletinin e rradhës

2. TREGUESIT KRYESORË TË VEPRIMTARISË AUDITUESE

2.1 Auditimet sipas llojit

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën Janar-Prill 2025, ka vijuar punën audituese në zbatim të planit të miratuar me vendimin nr. 218, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH, duke kryer dhe evaduar 16 misione auditimi, në vlerësim të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, performancës, IT dhe ndjekjes së statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në periudha të mëparshme. Detajuar sipas llojit të auditimit, aktiviteti auditues paraqitet në tabelën në vijim:

Infografik nr. 1: Misionet e auditimit të evaduara, në numër dhe përqindje ndaj totalit



2.2 Institucionet ku janë kryer auditimet

Në periudhën Janar - Prill 2025, auditimet e kryera kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit në 55 subjekte, duke përfshirë nivele të ndryshme të qeverisjes si: institucione qendrore, ministri dhe agjenci (përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre), njësi të vetëqeverisjes vendore, drejtori të përgjithshme të administrimit fiskal, si dhe shoqëri aksionere me kapital shtetëror në të cilat shteti zotëron mbi 50% të aksioneve, apo projekte me financim të huaj.

Infografik nr. 2: Kategoritë e institucioneve të audituara, në numër



2.3 Opinionet/mesazhet/konkluzionet sipas llojit të auditimit

Bazuar në planin vjetor 2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën Janar - Prill 2025, ka përfunduar kryerjen e 16 misioneve të auditimit, duke konkluduar në:

- 4 opinione për auditime përputhshmërie;
- 2 konkluzione në auditime IT
- 10 konkluzione mbi zbatimin e rekomandimeve
- 1 konkluzione në auditim financiar

Infografik nr. 3: Opinionet/mesazhet/konkluzionet



Opinionet, mesazhet dhe konkluzionet e auditimit, të ndara sipas llojit të auditimit, paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabela nr.1: Opinionet/mesazhet/konkluzionet sipas llojit të auditimit

Lloji i auditimit	Lloji i opinionit		Të tjera	Total
	I modifikuar	I pamodifikuar	Konkluzione	
Financiar	-	-	-	-
Të kombinuar nga të cilët:				
<i>Financiar</i>	-	-	1	1
<i>Përputhshmërie</i>	1	-	-	1
IT	-	-	2	2
Përputhshmërie	2	-		2
Performance	-	-	10	10
Përputhshmërie me çështje të veçantë (Tematik)	-	-	1	1
Total	3	-	14	17

Mbështetur në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISSAI 100), në bazë të gjetjeve të konkluduara mbi evidencat e auditimit, materialitetit dhe përhapjes, opinionet e dhënë mund të jenë “i modifikuar” ose “i pamodifikuar”. Në vijim:

Opinionet e pamodifikuar mund të jenë:

- të pakualifikuar, ose
- të pakualifikuar me theksim çështje


Opinionet e modifikuar mund të jenë:

- të kualifikuar,
- të kundërt, ose
- refuzues

Infografik nr. 4: Ndarja e opinionëve, mesazheve dhe konkluzioneve sipas llojit



2.4 Rekomandimet sipas natyrës



2.4.1 Masa organizative

Gjatë periudhës Janar-Prill 2025, për 16 auditimet e përfunduara, KLSH ka adresuar rekomandime për 73 masa organizative në institucionet publike të audituara, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës, të paraqitura më hollësisht në tabelën në vijim:


Tabela nr.2: Masa organizative

Grupet e institucioneve	Nr. auditimesh	Masa organizative
Institucione të pavarura, të qeverisjes qendrore dhe të varësisë	11	23
Institucione të vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	2	9
Shoqëri publike dhe projekte me financim të huaj	1	22
Institucionet në të cilat janë kryer auditimet IT	2	19
Total	16	73

2.4.2 Gjetje me efekte negative në të ardhura dhe shpenzime

Gjatë periudhës Janar-Prill 2025, janë dhënë 14 rekomandime mbi gjetje me efekte negative në buxhetin e shtetit, për total vlerën 1,046,089 mijë lekë, nga të cilat: dëmi ekonomik vlerësuar 4,973 mijë lekë, menaxhimi jo efektiv i fondeve në vlerën 994,370 mijë lekë dhe 46,746 mijë lekë në mangësi në aktivitetin kontrollues tatimor/doganor

Infografik nr. 6: Efektet negative financiare në buxhet sipas fushave kryesore (në '000 lekë)




Vlera e efekteve financiare me pasojë dëm ekonomik* në buxhetin e shtetit, është konstatuar 30% në fushën e të ardhurave dhe 70% në fushën e shpenzimeve. Në fushën e shpenzimeve, peshën më të madhe e zënë shkeljet e konstatuara përgjatë zbatimit të punimeve në vlerën 2,901 mijë lekë (likuidime për punime të pakryera); Ndërsa në fushën e të ardhurave, peshën më të madhe e zënë të ardhurat e munguara nga administrimi i pasurisë shtetërore dhe marrëdhëniet kontraktuale me palët e treta, në shumën prej 1,472 mijë lekë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë periudhës Janar – Prill 2025, ka evidentuar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ* në performancën e administrimit të të ardhurave, shpenzimeve dhe në përdorimin e fondeve publike në vlerën totale 994,370 mijë lekë nga të cilat:

- 992,027 mijë lekë në fushën e të ardhurave (ose rreth 99.8% e totalit) kryesisht në të ardhurat e qeverisjes lokale për çështje që lidhen me detyrime për taksat dhe tarifatat vendore, mos tarifimit/përlllogaritjes së gabuar/mos aplikim të kamat vonesave për përdorimin e pronave të bashkisë nga subjektet private; dhe
- 2,343 mijë lekë në fushën e shpenzimeve (ose rreth 0.2% e totalit), si rezultat i shkeljeve të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve.

*Vlera e detajuar e dëmit ekonomik, gjendet e pasqyruar në Aneksin nr. 4.4

**Vlera e detajuar e menaxhimit jo efektiv sipas subjekteve, gjendet e pasqyruar në Aneksin nr. 4.5



KLSH, për periudhën Janar – Prill 2025, ka konstatuar mangësi në aktivitetin kontrollues tatimor me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave tatimore & doganore, si detyrime dhe penalitete të vlerësuara në vlerën 46,746* mijë lekë, konstatuar në:

- Degën Doganore Rinas si pasojë e mos arkëtimit të detyrimeve doganore; pagesa detyrimesh doganore në import për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kuadrin ligjor, vlerësime të gabuara të importeve dhe deklarimeve të artikujve, përjashtim i padrejtë nga pagimi i TVSH-së dhe trajtim i gabuar i shkeljeve doganore.

*Vlera e detajuar efekteve negative të konstatuara në fushën e tatimeve dhe doganave, gjendet e pasqyruar në Aneksin nr. 4.6

Tabela më poshtë paraqet vlerën e dëmit ekonomik, menaxhimit jo efektiv të fondeve, dhe mangësive në aktivitetin kontrollues tatimor me ndikim në performancën e administrimit të të ardhurave tatimore/doganore, të organizuar sipas fushave ku është konstatuar parregullsia:

Tabela 3: Efekte negative ne buxhetin e shtetit, në mijë lekë


Efekte negative financiare	Dëm ekonomik	Menaxhim jo efektiv	Ndikim negativ tatime/dogana (aktiviteti kontrollues)	Total
Shpenzime	3,501	2,343	-	5,844
Procedura prokurimi	600	0	-	600
Shpenzime operative	0	2,343	-	2,343
Zbatim punimesh	2,901		-	2,901
Të ardhura	1,472	992,027	49,746	1,040,245
Detyrime dhe penalitete te vlerësuara në tatime & dogana			872	872
Të ardhura nga administrimi i pasurisë shtetërore dhe marrëdhëniet kontraktuale me palë të treta	1,472	397,014		398,486
Të ardhura nga aktiviteti doganor			45,874	45,874
Të ardhura të tjera	-	595,013	-	595,013
Total	4,973	994,370	46,746	1,046,089

2.5 Masa disiplinore dhe administrative

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara, ka adresuar tek subjektet e audituara 5 rekomandime për masa administrative dhe disiplinore, nga të cilat 5 masa disiplinore.

Konkretisht, për shkeljet e konstatuara në bazë të ligjit të mësipërm, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 58 dhe Kodit të Punës, KLSH u ka kërkuar organeve respektive shqyrtimin dhe marrjen e 4 masave disiplinore (pasi për 1 masa, punonjësit kanë rezultuar të larguar nga puna).

Infografik nr. 7: Masat disiplinore sipas ligjit për nëpunësin civil dhe sipas kodit të punës



3.1 OPINIONET NË AUDITIME



AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA TIRANË, NË ADMINISTRATËN E ZONAVE TË MBROJTURA ADZM KUKËS, ADZM BERAT DHE ADZM VLORË

Në veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar për përputhshmërinë, Anomalitë e konstatuara, janë si më poshtë:

- Janë konstatuar 784 ndërtime dhe aktivitete in formale, që i përkasin periudhës kohore kryesisht para vitit 2015, para formimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), të cilat janë adresuar tek institucionet ligj zbatuese, por nuk konfirmohet kthim përgjigje prej tyre.

-Deri në 30.09.2024 janë lidhur gjithsej 105 kontrata qiraje, për dhënie në përdorim të sipërfaqeve në zonë të mbrojtur, nga të cilat 53 prej tyre në vlerë 397,013,980 lekë rezultojnë me detyrime të papaguara dhe të pa kontabilizuara, të përbërë nga: 27 subjekte me veprimtari ekonomike të ndryshme me detyrim në vlerë 29,505,449 lekë (16 në proces gjyqësor, 4 kallëzim penal, 7 në negociatë për lidhje akt marrëveshje) dhe 26 HEC-e me detyrime të pa paguara në vlerë 367,508,531 lekë (25 në proces gjyqësor, 1 kallëzim penal), që përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.

-Lidhur me dy procedurat e prokurimit me objekt: "Shërbime për hartimin e termave të referencës për hartim projekte zbatimi" me vlerë të realizuar gjithsej 7,227,472 lekë pa T.v.sh, u konstatua se: nga grupi i punës, përllogaritja e fondit limit nuk është bërë specifikisht sipas përbërjes së zërave të kostos (nga kosto ekspertësh, kosto administrative) dhe sipas termave të referencës të përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Hartime Planesh të Integruara të Menaxhimit" datë 15.10.2021 ka rezultuar vlera 600,000 lekë dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, veprime të kryera në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

-Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike me objekt: "Ndërtim i hapësirave publike për akomodimin e automjeteve dhe aksesimin e tyre në zonën e mbrojtur "Syri i Kaltër" rezultuan punime të pakryera, nga kontraktori "F....." sh.p.k, në vlerën prej 2,901,420 lekë me T.v.sh, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.

-Nga analiza e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" në pasqyrën e pozicionit financiar rezultoi se, kjo llogari në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 3,528,693 lekë dhe në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërsa në pasqyrën nr. 5, "Shënime shpjeguese për periudhën raportuese të bilancit" paraqitet me vlerën 148,426,101 lekë.

Nga Drejtoria e Financës nuk u paraqit analizë se kujt i përkasin detyrimet e vitit 2022 dhe mungon dokumentacioni i nevojshëm kontabël e ligjor për heqjen e tyre në fund të vitit 2023. Ndërsa nga auditimi, rezultoi se vlera e detyrimeve të papaguara e të pa kontabilizuara nga kontratat e qirasë, deri në 30.09.2024 është në vlerë të konsiderueshme, në total 397,013,980 lekë.

-Nga analiza e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar) Deficiti i akumuluar" rezultoi se, teprica në çelje e fondeve neto është pasqyruar gabimisht duke iu referuar mbylljes së vitit 2021, me një shumë prej 306,793,959 lekë, ndërkohë që duhet të ishte në shumën prej 805,735,096 lekë, sipas mbylljes së vitit të mëparshëm 2022.



DEGA DOGANORE RINAS

Nga auditimi i ushtruar në Degën Doganore Rinas, në zbatim të programit të auditimit me nr. 1269/1 prot., datë 23.10.2024, me objekt "Auditim përputhshmërie", për veprimtarinë nga data 01.07.2022 deri më 31.12.2024, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjekti i audituar, janë konstatuar problematika në lidhje me vlerësimin dhe importimin e artikujve të kategorisë "pajisje mjekësore", për të cilat nuk janë zbatuar procedurat për kryerjen e kontrolleve dokumentare dhe fizike lidhur me importin e implanteve mjekësore, të cilat përfitojnë nga përjashtimi nga TVSH-ja. Gjithashtu, në importet dhe deklarimet e artikujve të përfshirë në kapitullin 85 kodi tarifar 85171300 Smartphones të NKM, me origjinë EU/NEU, si dhe për mallrat e blera me çmime të zbritura, janë konstatuar mangësi në procesin e vlerësimit doganor. Këto mangësi, të trajtuara në mënyrë të detajuar në bazën për opinionin, të cilat sipas gjykimit tonë, justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar nga auditimi.



KORPORATA E INVESTIMEVE SHQIPTARE

Nga auditimi i ushtruar në Korporatën e Investimeve Shqiptare SHA (AIC) në zbatim të programit të auditimit me nr. 1096/1, datë 16.09.2024, i ndryshuar, me objekt "Auditim përputhshmërie", për periudhën e veprimtarisë nga data 17.10.2019 deri me datën 30.06.2024, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga subjekti i audituar, u konstatuan veprime të kryera jo në pajtueshmëri me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi, me anomali materiale të shprehura mbi mungesën e efektivitetit të veprimtarisë së subjektit, të cilat justifikojnë dhënien e opinionit të kualifikuar të auditimit. Baza për opinionin e përputhshmërisë

- Planifikimi buxhetor i Korporatës së Investimeve Shqiptare SHA është kryer në mënyrë të pamjaftueshme dhe pa argumentim të detajuar, me mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet parashikimeve dhe realizimeve, duke ndikuar negativisht në performancën ekonomiko-financiare të shoqërisë.

- Korporata e Investimeve Shqiptare SHA nuk ka implementuar manuale, udhëzues apo metodologji të standardizuara për hartimin, seleksionimin dhe menaxhimin e projekteve, duke cënuar procesin strategjik dhe realizimin e objektivave të saj.

- Projekt-propozimet e hartuara nga Korporata e Investimeve Shqiptare SHA gjatë viteve 2022-2024 janë realizuar pa respektuar procedurat e përcaktuara, me mungesë analizash të detajuara mbi risqet, objektivat dhe përfitueshmërinë, duke pamundësuar vlerësimin e impaktit ekonomik dhe përfitimeve të mundshme.

- Nga auditimi i veprimtarisë së AIC-së, konstatohet se ka një ndërprerje në realizimin e projekt-propozimeve të mëparshme, duke përfshirë ato në sektorin e energjisë dhe zhvillimit të zonave prioritare, edhe pse janë kryer shpenzime mbi kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për realizimin e para-fizibilitetit.

- Nga auditimi i projekt-propozimeve në kuadër të Zhvillimit të Pronave Shtetërore, konstatohet se nuk ka një dokument/rregullore/manual, mbi identifikimin dhe përzgjedhjen e tyre, si dhe nuk ka një analizë mbi përfitueshmërinë, kostove financiare, risqet potenciale, vlerën e shtuar të parasë, rentabilitetin e investimit, apo për hapat konkrete që do duhet të ndiqen për çdo projekt propozim përpara shpalljes së tij, të tilla si parafizibiliteti/fizibiliteti sikundër vepruar për projektet e periudhës 2022-2023; si dhe një analizë krahasuese nëse këto projekt-propozimet do të zhvilloheshin nga vetë Institucionet, me financim të brendshëm nga buxheti i shtetit.
- Korporata e Investimeve Shqiptare (AIC) miratoi një hua prej 2 miliard lekë për Albcontrol SHA për të përballuar mungesën e likuiditetit, e cila është miratuar me vendimet e Këshillit Mbikëqyrës dhe miratimit nga Asambleja e Aksionerëve. Nga auditimi u konstatua se në përfundim të afatit 1-vjeçar të kontratës së huasë, nga ana e Albcontrol nuk është likuiduar, pasi ka kërkuar shtyrjen e afatit me një vit për kthimin e huasë.
- Korporata e Investimeve Shqiptare ka dorëzuar pasqyrat financiare dhe deklaratat e tatim-fitimit për vitet 2020-2023 me dy versione, duke tejkalluar afatet ligjore dhe duke u ekspozuar ndaj penalteteve dhe interesave për mosrespektimin e afateve dhe ndryshimeve. Për më tepër, përgjegjësitë për përgatitjen e pasqyrave financiare nuk janë të mirëpërcaktuara midis Drejtorit Ekzekutiv dhe Drejtorit të Financës, duke shkaktuar paqartësi dhe mungesë të qartësisë institucionale.
- Auditimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në AIC konstatoi vonesa në dorëzimin e deklaratave dhe vetëvlerësimeve, mungesë të manualeve, strategjive të riskut, dhe dokumentacioni të përditësuar, si dhe standardizim të pamjaftueshëm në proceset kryesore të punës.
- Nga auditimi u konstatua mungesë dokumentacioni për vërtetimin e përmbushjes së kriterëve nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe strukturë e paplotë e Këshillit, përfshirë mungesën e një kryetari gjatë periudhës 2020-2023. Gjithashtu, u konstatua se termat e shpërblimit për anëtarët e pavarur "jo ndërkombëtarë" nuk ishin të përcaktuara qartë, duke rezultuar në shpërblime të ndryshme me ato të anëtarëve nga institucionet qendrore.
- Lidhja e kontratës së qirasë me çmim mbi referencën fiskale për ambiente zyrash tregon mungesë efektiviteti në shpenzimet operative dhe shmangien nga parimi i ekonomicitetit.
- Nga verifikimi i procedurave të rekrutimit, rezultoi se për 4 nga 6 raste të përzgjedhura nga grupi i auditimit nuk disponohet informacion mbi procedurat e rekrutimit të tyre, pasi janë punësuar përpara hyrjes në fuqi të Rregullores së brendshme, ndërsa për dy punonjësit e tjerë ku janë kryer procedura standarde rekrutimi rezultuan mangësi në dokumentacion.

3.2 KONKLUZIONET NË AUDITIMET IT



QENDRA E ARSIMIT BASHKIA LUSHNJE

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në, ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, vlerësojmë se Qendra Arsimore pranë Bashkisë Lushnje nuk ka zhvilluar apo parashikuar sisteme dhe fonde për Teknologjinë e informacionit në buxhetet e viteve 2023-2024, në kundërshtim me kërkesat e nenit 37 të Rregullores së Brendshme nr.36 ,datë 06.04.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Lushnje”.

- Gjithashtu, infrastruktura ekzistuese rezultoi e amortizuar dhe joefikase, ku mungon sigurimi bazë si, fireëall dhe sëitch të menaxhueshëm; pajisjet kompjuterike janë të vjetra dhe përdorin sisteme operative të pasigurta, si dhe mungesë zbatimi të procedurave për sistemet e monitorimit (kamera) në çerdhe dhe kopshte.

Për këto arsye, është e domosdoshme dhe urgjente që të kryhet një studim i detajuar i nevojave për infrastrukturën IT dhe të sigurohen fonde për ndërtimin dhe modernizimin e sistemeve, duke respektuar udhëzimet e AKSHI-t dhe duke u bazuar në praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare në këtë fushë.



DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË

Grupi i auditimit është mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, përkatësisht ISSAI 100 - Parimet themelore të auditimit në sektorin publik, ISSAI 5300 - Udhëzime për auditimin e IT-së dhe ISSAI 5310 - Metodologjia e Rishikimit të Sigurisë së Sistemit të Informacionit, si dhe në nenet 3 dhe 14 të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Nga auditimi i kryer është evidentuar se infrastruktura IT e Drejtorisë Rajonale Arsimore Parauniversitar Lezhë përballet me problematika të rëndësishme që kërcënojnë sigurinë, si rrjedhojë e mungesës së një infrastrukture rrjeti të qëndrueshme, për shkak të mos implementimit të një fireëall-i dhe mungesës së mbrojtjes nga viruset, e cila kërcënon sigurinë dhe vazhdimësinë e shërbimeve të institucionit. Po ashtu, mungesa e politikave të qarta për menaxhimin e aksesit dhe ndarjen e llogarive ndërmjet përdoruesve paraqet një rrezik serioz për integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave. Pa një sistem autentifikimi dhe autorizimi të qartë, gjurmimi i përgjegjësive për veprimet e kryera në sistem bëhet i pamundur. Përdorimi i fjalëkalimeve të dobëta dhe mungesa e një mekanizmi të menaxhimit të tyre e ekspozon institucionin ndaj sulmeve. Gjithashtu, ekspozimi fizik i pajisjeve IT pa masa mbrojtëse dhe mungesa e një qendre të menaxhimit të rrjetit riskojnë sigurinë dhe administrimin e infrastrukturës teknologjike.



AUDITIMI TEMATIK “MBI ANKESËN E BANORËVE TË FSHATIT PISKOVË PËR VENDDEPOZITIMIN EKZISTUES TË MBETJEVE URBANE”

Nga auditimi i kryer pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Bashkisë Përmet në lidhje me “Ankesën e banorëve të fshatit Piskovë në lidhje me venddepozitimin e mbetjeve urbane” rezultuan mangësi kryesisht në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Nga auditimi u konstatua se venddepozitimi i Piskovës nuk ka qenë i raportuar si venddepozitim ilegal, në Raportin Final të përgatitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe si pasojë nuk mund të ndiqej procedura “e rehabilitimit”.

Për venddepozitimin ekzistues të Piskovës mungon dokumentacioni: studimi sizmik, klimatiko-meteorologjik, vërtetim nga kadastra e bashkisë /qarkut mbi kategorizimin e truallit që kërkohet për shfrytëzim, vëzhgime, prova dhe testime të terrenit, opinioni publik (dëgjesa me publikun), dokumentat e pronësisë, procedurat e përzgjedhjes së vendit për ndërtimin e landfillit (është marrë në konsideratë vetëm një alternativë), vlerësimi ekonomik, oponenca teknike nga Instituti i Ndërtimit, miratimi i studimit në organet e tjera përkatëse.


4. NIVELI I PRANUESHMËRISË SË REKOMANDIMEVE

Gjatë periudhës janar-gusht 2024, Kontrolli i i Lartë i Shtetit ka rekomanduar 92 masa, nga të cilat: 73 janë masa organizative, 3 masa shpërblim dëmi, 6 masa me efekte negative për shkak të parregullsive dhe 5 masa si pasojë e mangësive të konstatuara në aktivitetin kontrollues tatimor & doganor, me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave tatimore/doganore dhe 5 masa disiplinore.

Nga total 92 masat, kanë përmbushur afatin ligjor* prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes mbi pranueshmërinë e rekomandimeve, 92 masa, nga të cilat janë pranuar 92, ose 100%.

Niveli i pranueshmërisë sipas llojit të rekomandimit, rezulton si më poshtë:

Infografik nr. 8: Pranueshmëria e masava sipas llojit



* sipas nenit 15, shkronja j të ligjit nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"

Shënim: Për subjektet që nuk kanë sjellë përgjigje brenda 20 ditëve sipas nenit 15, shkronja j të ligjit nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", automatikisht statusi i rekomandimeve konsiderohet "i pranuar". Për subjektet, të cilat edhe pse kanë respektuar afatin 20 ditor në kthimin e përgjigjes, por në shkresë nuk shprehen mbi pranueshmërinë e masës, masa do të konsiderohet "e pranuar".

Nga 92 masa në total, kanë përmbushur afatin ligjor 20 ditor të kthimit të përgjigjes, 92 masa. Nga 92 masat, të cilat kanë përmbushur afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes, janë pranuar 92 ose 100%.

Konkretisht:

- nga 73 masa organizative, kanë përmbushur afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes 73, nga të cilat janë pranuar 73 ose 100%;
- nga 3 masa shpërblim dëmi, kanë përmbushur afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes 3 prej tyre, nga të cilat janë pranuar 3 ose 100%;
- nga 6 masa 3-E - efekte negative për shkak të parregullsive, kanë përmbushur afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes 6 prej tyre, nga të cilat janë pranuar 6 ose 100%;
- nga 5 masa - mangësi në aktivitetin kontrollues tatimore me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave tatimore dhe doganore, kanë përmbushur afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes 5 prej tyre, të cilat janë pranuar plotësisht ose 100%;
- nga 5 masa disiplinore, kanë përmbushur afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes 5 prej tyre, nga të cilat janë pranuar 5 ose 100%;

5. ZHVILLIMI & MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

5.1 STRUKTURA DHE ORGANIKA

Gjatë periudhës Janar- Prill 2025, KLSH ka vijuar të adresojë menaxhimin e burimeve njerëzore në linjë me objektivat e përcaktuara në Dokumentin e Politikave të Burimeve Njerëzore dhe në funksion të realizimit të mbulimit me auditim sipas detyrimeve ligjore.


Në fund të periudhës raportuese, numri faktik i punonjësve është 216 punonjës, nga të cilët 162 janë staf auditues (ose 75% e numrit total të punonjësve) të përbërë nga:

- 15 kryeauditues
- 29 auditues të lartë
- 89 auditues të parë
- 29 auditues të dytë

Gjatë periudhës Janar-Prill 2025, në KLSH:


- janë rekrutuar 7 punonjës të rinj sipas procedurave të ligjit të nëpunësit civil dhe 2 punonjës referuar përcaktimeve të Kodit të Punës; si dhe
- janë ndërprerë marrëdhëniet administrative me KLSH-në, për 7 punonjës si rezultat i mbushjes së moshës për pension pleqërie, dorëheqje, lëvizje paralele, etj.

Infografik nr. 9: Organizimi i Burimeve Njerëzore



5.2 ZHVILLIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL


Gjatë periudhës Janar - Prill 2025, u realizuan 58 tema trajnimesh, nga të cilat 7 organizuar nga ASPA dhe 51 nga KLSH & partnerë si EUROSAI, IDI, CEF, SAI-e homologe, etj. U trajnuan gjithsej 150 staf auditues, duke realizuar mesatarisht 14 dite trajnimi / staf auditues për periudhën 4 mujore (nga mesatarisht 6 - 7 ditë trajnimi që është objektivi 4 mujor). Ndërsa janë realizuar trajnime për 37 punonjës, staf jo-auditues, duke realizuar mesatarisht 8 ditë trajnimi/punonjës, në 4 muaj (nga minimumi 2 ditë trajnimi që është objektivi 4 mujor). Gjatë këtij viti rreth 22% e trajnimeve u realizuan në sallë, me prezencë fizike, ndërsa 78% e tyre on-line.



Ndër temat kryesore, objekt trajnimi gjatë këtij 4 mujori, të vitit 2025, rendisim çështje që lidhen me:

- E drejta e informimit dhe mbrojtja e të drejtave personale
- Kodi i procedurave administrative
- Hartimi i procedurave të klasifikuara, legjislacioni i veçantë, si dhe çdo informacion tjetër në lidhje me auditimin
- Kodi Etik
- Ligji i Prokurimit Publik për zbatimin e kontratave
- Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit (SoAQM): Kalimi nga Kontrolli Cilësisë në Menaxhim Cilësisë në KLSH
- Standardet në auditim (INTOSAI)
- Inteligjenca artificiale dhe ndikimi i saj në auditimin publik
- Siguria e digave / zhvillohet midis KLSH dhe ZKA Kosovë
- Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshë -seri trajnimesh në kuadër të auditimit të përbashkët, me SAI-n e Izraelit
- Keqpërdorimi i IT në krimet financiare, etj.

Infografik nr. 10: Ditët e trajnimeve për stafin auditues dhe jo-auditues, Janar-Prill 2025



*Objektivat vjetore për realizimin e diteve të trajnimit për stafin auditues dhe jo-auditues për vitin 2025, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 18, datë 21.01.2025 "Për miratimin e Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të Stafit të KLSH-së, për vitin 2025".


6. PROGRAMI I TRANSPARENCËS DHE E DREJTA PËR INFORMIM

Kontrrolli i Lartë i Shtetit vijon të shqyrtojë me korrektësi dhe profesionalizëm të gjitha ankesat, denoncimet dhe kërkesat për informacion të ardhura nga qytetarët dhe media të ndryshme. Konkretisht, gjatë periudhës Janar - Prill 2025, ka administruar 88 letra nga qytetarët dhe palët e ndryshme të interesit në formën e ankesave, kërkesave për informacion apo denoncimeve. Numri më i madh i këtyre ankesave ka marrë një përgjigje brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj. Një pjesë e tyre mbeten në proces verifikimi në auditime të radhës sipas tematikave përkatëse, në përfundim të të cilave KLSH informon menjëherë qytetarin.

Ndërkohë, ankesa të vlerësuara jashtë fushës së kompetencave të KLSH-së, i janë dërguar për kompetencë institucioneve përgjegjëse ose është orientuar qytetari nëpërmjet përgjigjeve zyrtare se cilit institucion duhet t'i drejtohet, për të marrë përgjigje lidhur me problematikën që trajton.

Gjithashtu, në bazë të ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", Kontrrolli i Lartë i Shtetit gjatë periudhës Janar - Prill 2025, ka trajtuar 6 kërkesa për informacion të ardhura nga qytetarë, deputetë dhe përfaqësues të medias. Këto kërkesa kanë qenë kryesisht kërkesa mbi vënien në dispozicion të raporteve të ndryshme të auditimit të kryera nga KLSH dhe janë përcjellë tek kërkuuesi brenda afateve ligjore të përcaktuara.

Infografik nr. 11: Nr i ankesave, denoncimeve dhe kërkesave administruar në KLSH, Janar - Prill 2025



7. KLSH NË MEDIA

Auditimet të ndryshme kanë vijuar të trajtohen në media edhe përgjatë 4-mujorit të parë të vitit 2025.

Gjatë periudhës Janar-Prill 2025, veprimtaria e KLSH-së është pasqyruar në media me një total prej 324 artikujsh. 36 artikuj në shtypin e shkruar dhe 288 artikuj në median audio-vizive dhe online, që pasqyrojnë gjetjet e raporteve përfundimtare të auditimit dhe rekomandimet e lëna për subjektet e audituara.

Ndër auditimet me më shumë impakt në media gjatë këtij 4-mujori kanë qenë:

- Auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Universitar
- Auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Radio Televizionit Shqiptar
- Auditimi “Politikat dhe respektimi i të drejtave të personave me probleme të shëndetit mendor në shërbimin spitalor psikiatrik”
- Auditimi “Orientimi për Karrierë i të Rinjve në Sistemin Arsimor Parauniversitar”
- Auditimi “Mbrojtja e vlerave dhe pasurisë së vendit tonë në UNESCO”

Në auditimet e pasqyruara në media janë trajtuar gjetjet e raporteve, si: mungesa e disa barnave të rëndësishme të rimbursueshme në treg duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë te një numër i konsiderueshëm pacientësh. Po ashtu, impakt në media ka pasur edhe çështja e trajtimit të personave me probleme të shëndetit mendor në spitalet psikiatrike. Nga auditimi kryer në spitalet publike psikiatrike në Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Shkodër ka rezultuar mbipopullim i dhomave me pacientë me diagnoza të ndryshme, mungesë infrastrukture dhe stafi mjekësor etj.




Tabela 1: Misionet e auditimit në numër, sipas llojit

Lloji i auditimit	Nr. Auditimesh	Pesha në %
IT	2	13%
Përputhshmërie	2	13%
Tematik	1	6%
Zbatim rekomandimesh	10	62%
I kombinuar	1	6%
Total auditime	16	100%

Tabela 1.1: Misionet e auditimit në numër, sipas departamenteve

Departamenti	Nr. Auditimesh
Departamenti i Auditimit IT	2
Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit	2
Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetqeverisjes Vendore	2
Departamenti i Auditimit të Performancës	10
Total	16

Tabela 1.2: Auditimet/temat e auditimit specifike, sipas çdo departamentit të auditimit

Departamenti	Nr. Auditimesh
Departamenti i Auditimit IT	2
Drejtoria Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë	1
Qendra e Arsimit Bashkia Lushnje	1
Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit	2
Dega Doganore Rinas	1
Korporata e Investimeve Shqiptare	1
Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetqeverisjes Vendore	2
Mbi zbatimin të rekomandimeve për 6 mujorin II, të vitit 2023, për subjektet e Vetqeverisjes Vendore	1
Verifikim i ankesës së banorëve të fshatit Piskovë në lidhje me venddepozitimin e mbetjeve urbane	1
Departamenti i Auditimit të Performancës	10
Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë	1
Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës me temë "Shërbimi i policisë në përgjigje të qytetarëve"	1
Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës me temë "Trajtimi i sëmundjeve tumorale"	1
Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës me temë "Efektiviteti i procesit të certifikimit të materialit mbjellës bimor (fara e fidanë), i përdorur nga fermerët"	1
Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës me temë "Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje me fokus, gratë e dhunuara"	1
Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës me temë "Performanca e ofrimit të shërbimeve on line"	1
Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës me temë "Performanca e sistemit të shfrytëzimit minerar të mermerëve"	1
Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, evaduar në vitin 2023	1
Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, evaduar në vitin 2023	1
Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës me temë "Shërbimi në terapinë renale dhe zëvendësuese"	1
Total	16

Tabela 2: Opinione/mesazhe/konkluzione sipas llojit

	llojet e opinionit (mod/pamod)		
Lloji i auditimit	I modifikuar përputhshmëria	Konkluzion	Grand Total
IT		2	2
Përputhshmërie	2		2
Përputhshmërie me çështje të veçantë (Tematik)		1	1
Zbatim rekomandimesh		10	10
I kombinuar	1	1	2
Total	3	14	17

Tabela 2.1: Kualifikimi i opinioneve sipas llojit të auditimit

	Kualifikimi i opinioneve		
Lloji i auditimit	I kualifikuar	Konkluzion	Total
IT		2	2
Përputhshmërie	2		2
Përputhshmërie me çështje të veçantë (Tematik)		1	1
Zbatim rekomandimesh		10	10
I kombinuar	1	1	2
Total	3	14	17

Tabela 2.2: Kualifikimi i opinioneve sipas subjekteve

	Kualifikimi i opinioneve		
Lloji i auditimit	I kualifikuar	Konkluzion	Total
IT			
Qendra e Arsimit Bashkia Lushnje		1	1
Drejtoria Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë		1	1
IT Total	0	2	2
Përputhshmërie			0
Dega Doganore Rinas	1		1
Korporata e Investimeve Shqiptare	1		1
Përputhshmërie Total	2	0	2
Tematik			0
Verifikim i ankesës së banorëve të fshatit Piskovë në lidhje me venddepozitimim e mbeqjeve urbane		1	1
Tematik Total	0	1	1
Zbatim rekomandimesh			
Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës me temë "Shërbimi i policisë në përgjigje të qytetarëve"		1	1
Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës me temë "Trajtimi i sëmundjeve tumorale"		1	1
Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës me temë "Efektiviteti i procesit të certifikimit të materialit mbjellës bimor (fara e fidanë), i përdorur nga fermerët"		1	1
Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës me temë "Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje me fokus, gratë e dhunuar"		1	1
Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës me temë "Performanca e ofrimit të shërbimeve on line"		1	1
Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës me temë "Performanca e sistemit të shfrytëzimit minerar të mermerëve"		1	1
Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, evaduar në vitin 2023		1	1
Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, evaduar në vitin 2023		1	1
Mbi zbatimin e rekomandimeve për 6 mujorin II, të vitit 2023, për subjektet e Vetqeverisjes Vendore		1	1
Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës me temë "Shërbimi në terapinë renale dhe zëvendësuese"		1	1
Zbatim rekomandimesh Total	0	10	10
I kombinuar			0
Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë	1	1	2
I kombinuar Total	1	1	2
Total	3	14	17

Tabela 3: Masat organizative, sipas subjekteve të audituara

Nr. kum	Nr. Ren	Lloji i institucionit ku ushtrohet auditimi	M. organizative
		Institucione të qeverisjes qendrore dhe të vartësisë	23
1	1	Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë	15
2	2	Dega Doganore Rinas	8
		Institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe ente të tjera lokale	9
3	1	Verifikim i ankesës së banorëve të fshatit Piskovë në lidhje me venddepozitimin e mbetjeve urbane	9
		Institucionet në të cilat janë kryer auditimet IT	19
4	1	Qendra e Arsimit Bashkia Lushnje	10
5	2	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë	9
		Shoqëritë publike dhe projektet me financim të huaj	22
6	1	Korporata e Investimeve Shqiptare	22
		Total	73

Tabela 4: Vlera e efekteve negative (në '000 lekë)

Te Ardhura/Shpenzime	Dem/3E		Menaxhim joefektiv fondesh		Tatime dhe Dogana		Rekomandime gjithsej	Total efekte negative (ne mije leke)
	Rekomandimi (në nr.)	Vlera (në mije lekë)	Rekomandimi (në nr.)	Vlera (në mije lekë)	Rekomandimi (në nr.)	Vlera (në mije lekë)		
Shpenzime	2	3,501	2	2,343			4	5,844
Të Ardhura	1	1,472	4	992,027	5	46,746	10	1,040,245
Total	3	4,973	6	994,370	5	46,746	14	1,046,089

Tabela 4.1: Vlera e efekteve negative, të grupuara sipas ndikimit në të ardhura dhe shpenzime, dhe subjektet ku janë konstatuar efektet, (në '000 lekë)

Te Ardhura/Shpenzime	Dem/3E		Menaxhim joefektiv fondesh		Tatime dhe Dogana		Rekomandime gjithsej	Total efekte negative (ne mije leke)
	Rekomandimi (në nr.)	Vlera (në mije lekë)	Rekomandimi (në nr.)	Vlera (në mije lekë)	Rekomandimi (në nr.)	Vlera (në mije lekë)		
Shpenzime								
Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë	2	3,501					2	3,501
Korporata e Investimeve Shqiptare			2	2,343			2	2,343
Shpenzime Total	2	3,501	2	2,343	-	-	4	5,844
Të Ardhura								
Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë	1	1,472	3	990,397			4	991,869
Dega Doganore Rinas					5	46,746	5	46,746
Korporata e Investimeve Shqiptare			1	1,630			1	1,630
Të Ardhura Total	1	1,472	4	992,027	5	46,746	10	1,040,245
Total	3	4,973	6	994,370	5	46,746	14	1,046,089

Tabela 4.2: Vlera e efekteve negative, të grupuara sipas fushave kryesore (në '000 lekë)

Te Ardhura/Shpenzime	Dem/3E		Menaxhim joefektiv fondesh		Tatime dhe Dogana		Rekomandime gjithsej	Total efekte negative (ne mije leke)
	Rekomandimi (në nr.)	Vlera (në mije lekë)	Rekomandimi (në nr.)	Vlera (në mije lekë)	Rekomandimi (në nr.)	Vlera (në mije lekë)		
Shpenzime								
Procedura prokurimi	1	600					1	600
Shpenzime operative			2	2,343			2	2,343
Zbatim punimesh	1	2,901					1	2,901
Shpenzime Total	2	3,501	2	2,343			4	5,844
Të Ardhura								
Penalite të vlerësuara					1	872	1	872
Te ardhura nga administrimi i pasurisë shtetërore dhe marrëdhëniet kontraktuale me palët e treta	1	1,472	1	397,014			2	398,486
Te Ardhura nga aktiviteti doganor					4	45,874	4	45,874
Te Ardhura të Tjera			3	595,013			3	595,013
Të Ardhura Total	1	1,472	4	992,027	5	46,746	10	1,040,245
Total	3	4,973	6	994,370	5	46,746	14	1,046,089

Tabela 4.3: Vlera e efekteve negative, të grupuara sipas fushave kryesore, dhe subjekteve/ose temës ku është konstatuar efekti (në '000 lekë)

Te Ardhura/Shpenzime	Dem/3E		Menaxhim joefektiv fondesh		Tatime dhe Dogana		Rekomandim e gjithsej	Total efekte negative (ne mije leke)
	Rekomandim i (në nr.)	Vlera (në mije lekë)	Rekomandimi (në nr.)	Vlera (në mije lekë)	Rekomandimi (në nr.)	Vlera (në mije lekë)		
Shpenzime								
Procedura prokurimi	1	600					1	600
Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë	1	600					1	600
Shpenzime operative			2	2,343			2	2,343
Korporata e Investimeve Shqiptare			2	2,343			2	2,343
Zbatim punimesh	1	2,901					1	2,901
Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë	1	2,901					1	2,901
Shpenzime Total	2	3,501	2	2,343			4	5,844
Të Ardhura								
Penalitete të vlerësuara					1	872	1	872
Dega Doganore Rinas					1	872	1	872
Te ardhura nga administrimi i p...	1	1,472	1	397,014			2	398,486
Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë	1	1,472	1	397,014			2	398,486
Te Ardhura nga aktiviteti doganor					4	45,874	4	45,874
Dega Doganore Rinas					4	45,874	4	45,874
Te Ardhura të Tjera			3	595,013			3	595,013
Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë			2	593,383			2	593,383
Korporata e Investimeve Shqiptare			1	1,630			1	1,630
Të Ardhura Total	1	1,472	4	992,027	5	46,746	10	1,040,245
Total	3	4,973	6	994,370	5	46,746	14	1,046,089

Tabela 4.4: Vlera e dëmit ekonomik, sipas subjekteve/temës dhe fushës ku është konstatuar dëmi (në '000 lekë)

Dëmi Ekonomik sipas fushave	Rekomandimi (në nr.)	Vlera (në mijë lekë)
Shpenzime		
Procedura prokurimi	1	600
Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë	1	600
Zbatim punimesh	1	2,901
Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë	1	2,901
Shpenzime Total	2	3,501
Të Ardhura		
Te ardhura nga administrimi i pasurisë shtetërore dhe marrëdhë	1	1,472
Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë	1	1,472
Të Ardhura Total	1	1,472
Total	3	4,973

Tabela 4.5: Vlera e menaxhimit joefektiv të fondeve, sipas fushës dhe subjekteve/temës ku është konstatuar dëmi (në '000 lekë)

Menaxhim jo efektiv	Rekomandimi (në nr.)	Vlera (në mijë lekë)
Shpenzime		
Shpenzime operative	2	2,343
Korporata e Investimeve Shqiptare	2	2,343
Shpenzime Total	2	2,343
Të Ardhura		
Te Ardhura të Tjera	1	1,630
Korporata e Investimeve Shqiptare	1	1,630
Të ardhurat nga sektori i tatimeve në qeverisjen lokale	3	990,397
Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë	3	990,397
Të Ardhura Total	4	992,027
Total	6	994,370

Tabela 4.6: Vlera e mangësive në aktivitetin kontrollues tatimor/doganor me ndikim në performancën e administrimit të të ardhurave tatimore/doganore (në '000 lekë):

Mangësi në aktivitetin kontrollues tatimor/doganor	Rekomandimi (në nr.)	Vlera (në mije lekë)
Të Ardhura		
Penalitete të vlerësuara		
Dega Doganore Rinas	1	872
Penalitete të vlerësuara Total	1	872
Te Ardhura nga aktiviteti doganor		
Dega Doganore Rinas	4	45,874
Te Ardhura nga aktiviteti doganor Total	4	45,874
Të Ardhura Total	5	46,746
Total	5	46,746

Tabela 5: Masa disiplinore sipas kuadrit ligjor përkatës

Masa Disiplinore sipas kuadrit ligjor perkates	Masa Disiplinore (në nr.)
Ligji nr. 152/2013 dt.30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil” Neni 58, shkronjat (a,b,c ç)	4
<i>Kompetencë të Titullarit</i>	2
<i>Për punonjës të larguar nga puna</i>	1
<i>Vërejtje e shkrim</i>	1
Me Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës	1
<i>Kompetencë të Titullarit</i>	1
Total	5

Tabela 5.1: Masa disiplinore, sipas auditimit të kryer

Masa Disiplinore sipas kuadrit ligjor perkates	Masa Disiplinore (në nr.)
Ligji nr. 152/2013 dt.30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil” Neni 58, shkronjat (a,b,c ç)	4
Kompetencë të Titullarit	
<i>Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Tiranë, në Administratën e Zonave të Mbrojtura AdZM Kukës, AdZM Berat dhe AdZM Vlorë</i>	1
<i>Dega Doganore Rinas</i>	1
Për punonjës të larguar nga puna	
<i>Verifikim i ankesës së banorëve të fshatit Piskovë në lidhje me venddepozitimin e mbetjeve urbane</i>	1
Vërejtje e shkrim	
<i>Verifikim i ankesës së banorëve të fshatit Piskovë në lidhje me venddepozitimin e mbetjeve urbane</i>	1
Me Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës	1
Kompetencë të Titullarit	
<i>Korporata e Investimeve Shqiptare,</i>	1
Total	5

Buletini Statistikor Janar – Prill 2025

Të dhënat statistikore janë raportuar nga departamentet e auditimit dhe janë përpunuar nga Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional.

Buletini Statistikor Janar - Gusht 2024 është ideuar dhe përgatitur nga Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional

Marzhi i gabimit të lejuar në këtë analizë statistikore është përcaktuar në nivelin 5%, duke reflektuar një nivel të pranueshëm të pasigurisë statistikore, në përputhje me praktikat ndërkombëtare. Ky nivel është në përputhje me standardet e pranura nga Organizata Ndërkombëtare e Standardeve (ISO 3534-1:2006) dhe udhëzimet statistikore të OECD-së, të cilat rekomandojnë përdorimin e marzheve të gabimit të tilla në studimet me një shkallë të lartë të saktësisë.

© Kontrolli i Lartë i Shtetit

Materiali i paraqitur në këtë dokument i nënshtrohet të drejtës së autorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Materiali mund të kopjohet ose riprodhohet vetëm për qëllime jokomerciale, përkatësisht riprodhim për kërkime, studime private ose për qarkullim të brendshëm të kufizuar brenda një organizate për qëllime studimore dhe analitike.

Kopjimi për qëllime jokomerciale duhet të shoqërohet me një njohje të mjaftueshme, të riprodhohet me saktësi dhe të mos përdoret në një kontekst tjetër.



Rruga "Abdi
Toptani" Nr.1 Tiranë



klsh.org.al



+355 4 2247294



klsh@klsh.org.al